



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.11.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË LIPJANIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmerret edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike dhe do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Lipjanit në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Ramadan Gashi (Udhëheqës Ekipi), Selvete Foniqi dhe Valbona Pllana.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak	13
4 Qeverisja	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	30
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	33


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Lipjanit për vitin 2014, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 21/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes dëshirojmë të përmendim Nenin 13 në Pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit - shtylla e buxhetit final, ku hyrja dhe dalja e parasë së gatshme është nënvlerësuar për 136,310€.


(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).


Konkluzioni i përgjithshëm


Menaxhmenti i komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të kënaqshëm, megjithatë sistemi duhet të monitorohet për siguruar se kontrollet e brendshme janë në veprim të vazhdueshëm.

Në vazhdim do të prezantohen fushat në të cilat janë vërejtur mangësitë.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:







Përgjigja nga Menaxhmenti - auditimi për 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjeturat e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

Ne e marrim si punë të kryer faktin që Kryetari :

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicoj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës së Lipjanit të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operationale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato konsiderohen relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne, gjithashtu, e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të e dorëzuara në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Të dhënat e prezantuara në PVF nuk ishin të sakta dhe përmbanin gabime në shumat e prezantuara të buxhetit final dhe te pagesat e bashkëfinancimeve. Ndërsa sa i përket kërkesave të raportimit të jashtëm, ato ishin plotësuar.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes dëshirojmë të përmendim Nenin 13 në Pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit - shtylla e buxhetit final, ku hyrja dhe dalja e parasë së gatshme është nënvlerësuar për 136,310€.

(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Siç është vënë në pah në Memorandumin e Planifikimit të auditimit të datës 21/10/2014, ne kemi identifikuar dy rreziqe domethënëse që kanë të bëjnë me shpalosjen e pagesave nga palët e treta dhe regjistrimin e pasurisë. Rreziqet e identifikuara nga ne, nuk kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti kishte marr masat e duhura për t'i eliminuar. Rreziqet domethënëse janë rreziqe të keq deklarimeve materiale që sipas gjykimit tonë, kërkojnë vlerësim të veçantë të auditimit dhe mund të rezultojnë në modifikim të opinionit.

Qasja jonë deri më tani pasqyron reagimin tonë të auditimit, siç shpjegohet në detaje brenda memorandumit të planifikimit të auditimit dhe është përmbledhur si më poshtë.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Prezantimi i pagesave nga palët e treta

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne kemi shqyrtuar financimet e projekteve dhe pagesat e bëra për komunën nga ana e donatorëve të jashtëm. Ne kemi vërejtur se Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime konkrete në adresimin e këtij rreziku dhe ka bërë paraqitjen e pagesave nga palët e treta në PVF, në vlerë prej 106,000€.

Rreziku i identifikuar

Çështja 2 - Mos regjistrimi i pasurive në pronësi të Komunës

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive kapitale për vitin 2014. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që vlera e pasurive në PVF të ishte e plotë dhe e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar nuk ishte i materializuar pasi që zyrtari i pasurisë kishte arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në regjistrin e pasurive.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera të jashtme për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese të jashtme dhe kërkesat tjera për raportim. Ajo kishte përmbushur kërkesat raportuese si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e shpenzimeve të komunës;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet Operacionale (performancës);
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet e dorëzuar me kohë në Ministrinë e Financave mbi gjendjen e borxheve; dhe
- Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të MFK-së.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto, pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm dhe afatet kohore.

Në draft PVF kishte pasur nevojë që të bëheshin disa korrigjime financiare. Më pas, PVF janë përmirësuar. Mirëpo, përkundër përmirësimeve, mangësitë e mbetura janë përshkruar si më poshtë.

Çështja 3 - Procesi i përgatitjes së PVF - Prioritet i lartë

E gjetura	<p>Neni 13- raporti i ekzekutimit të buxhetit të shtylla e buxhetit final, hyrja dhe dalja e parasë së gatshme është nënvlerësuar për 136,310€;</p> <p>Komuna kishte keq deklaruar në PVF shpenzimet e investimeve kapitale, ku nga kategoria e investimeve kishte paguar mallra dhe shërbime në vlerë 24,122€;</p> <p>Komuna kishte bërë pagesa të parregullta nga kategoria investime kapitale në vlerë prej 33,988€ pa faturë, situacion për progresin e punës, raport të punës/mbikëqyrjes e as ndonjë raport për pranimin e punëve, por vetëm në bazë të marrëveshjeve (Për më tepër shih çështjen 12); dhe</p> <p>Te shënimi 18-Të arkëtueshmet, komuna ka shpalosur vlerën prej 3,655,725€, ndërsa sipas raportit shënimeve që ne kemi siguruar, vlera e llogarive të arkëtueshmeve është 3,663,794€. Diferenca në shifra është 8,069€.</p>
Rreziku	<p>Paraqitja jo e saktë e të dhënave në PVF dhe gabimet e identifikuar në shumatat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës. Nënvlerësimi i buxhetit final, pagesat e parregullta dhe keq klasifikimi i shpenzimeve kanë rezultuar me Theksim të çështjes në opinionin e auditimit.</p>
Rekomandimi 1	<p>Kryetari duhet të sigurojë që procesi i prodhimit të PVF-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuar. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.</p>

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar një plan për adresimin e rekomandimeve nga viti paraprak dhe ishte zotuar se do adresoj rekomandimet e dhëna. Megjithatë, vetëm disa rekomandime të vitit të kaluar janë zbatuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e komunës për vitin 2013 përmbante 19 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, 9 (nëntë) rekomandime ishte adresuar plotësisht, 9 (nëntë) ishin adresuar pjesërisht dhe 1 (një) i pa adresuar, Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 4 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vërehet një përmirësim në adresimin e rekomandimeve në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, gjysma e rekomandimeve mbeten ende të pa adresuara plotësisht për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.
- Rreziku** Dobësitë vazhdojnë të mbeten të pranishme në fushat ku adresimi i rekomandimeve ishte i pjesshëm apo në proces e sipër. Kontrollat e pamjaftueshme në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në problemet e njëjta sikurse në vitin e kaluar, sidomos në: vazhdimin e kryerje së pagesave para se të kryhen punimet, pagesat nga kodet jo adekuate ekonomike, etj.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit të përcaktojë një afat kohor konkret për adresimin e rekomandimeve të mbetura nga viti 2013 si dhe ato të këtij viti. Stafi përgjegjës dhe përcatimi i aktiviteteve që duhet të ndërmerren, duhet të jenë komponenta të këtij plani dhe të kenë fokus prioritar trajtimin e fushave më të rëndësishme, por duke mos injoruar edhe rekomandimet tjera. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Procedurat e një qeverisjeje të fortë kërkojnë që si aktivitetet strategjike ashtu edhe ato operacionale të zbatohen dhe monitorohen në mënyrë efektive. Ne kemi vlerësuar disa aktivitete që mund t'i kontribuojnë një qeverisje të mirë, si dhe mundësitë ekzistuese për përmirësim të mëtejshëm:

- Menaxhimi i rrezikut – Komuna nuk përgatitë një listë identifikimi për rreziqet potenciale dhe rrjedhimisht nuk bën monitorimin e tyre;
- Vetëvlerësimi - Komuna ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin që është kryer nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari kryesor financiar, por ka nevojë të përfshijë vlerësim më kritik ndaj arritjes së rezultateve;
- Një sistem i auditimit të brendshëm plotësisht funksional; dhe
- Një sistem i mirë i raportimit të brendshëm.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: planifikimi dhe realizimi i buxhetit në investime kapitale, klasifikimi i shpenzimeve, dhe raportimet e detajuara mbi progresin e investimeve kapitale.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrimi

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 - Korniza Qeverisëse - Prioritet i lartë

E gjetura Nuk ka një raportim formal dhe sistematik që i ndërlihd objektivat e Komunës me rezultatet. Kjo ndikoi në efikasitetin e çasjes tonë audituese për 2014 sepse nuk kishim mundësi të marrim siguri direkte nga Kontrolltet e Nivelit të Lartë të Menaxhmentit.

Komuna nuk ka prezantuar një regjistër të rreziqeve, kërkesë kjo e procedurës numër katër të dokumentit të Thesarit “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”.

Këto çështje pasqyrojnë një mungesë të fokusit mbi rëndësinë e një kornize të formalizuar të qeverisjes që të përballet me shqyrtim të hollësishëm dhe sfida.

Rreziku Korniza qeverisëse joefektive mund të rezultojë në mos arritje apo vonesa në përmbushjen e objektivave të organizatës dhe me humbje potencialisht financiare.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurohet që korniza qeverisëse aktuale është rishikuar dhe janë identifikuar hapësirat/kërkesat ligjore të pazbatuara dhe aspektet e raportimit efektiv. Përmirësimet e nevojshme, përfshirë këtu një regjistër të rreziqeve të nivelit të lartë, duhet të implementohen deri në fund të vitit 2015 dhe të monitorohet në baza tremujore.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Lipjanit, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	11,333,444	13,249,720	12,035,270	11,264,304	11,351,262
Granti i Qeverisë -Buxheti	10,166,517	11,225,244	11,011,614	10,156,396	10,140,584
Të bartura nga viti paraprak ²	-	395,068	353,095	232,968	313,996
Të hyrat vetjake ³	1,166,927	1,623,310	664,950	822,940	880,766
Donacionet e brendshme	-	6,098	5,611	-	10,000
Donacionet e jashtme	-	-	-	57,000	5,916

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,916,276€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore (6,098€), të hyrave të bartura nga viti paraprak (395,068€), rritja e hyrave në buxhetin final (456,383€) dhe rritja e grantit qeveritar (1,058,727€). Në vitin 2014, Komuna e Lipjanit ka shpenzuar 91% të buxhetit final, një performancë mjaft e mirë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,333,444	13,249,720	12,035,270	11,269,304	11,351,262
Pagat dhe Mëditjet	6,793,498	7,852,340	7,801,403	6,738,235	6,744,399
Mallrat dhe Shërbimet	983,145	1,352,518	935,195	815,574	742,386
Shërbimet komunale	256,500	300,418	236,323	204,747	119,972
Subvencionet dhe Transferet	200,000	255,315	203,586	179,550	138,064
Investimet Kapitale	3,100,301	3,489,129	2,858,763	3,331,198	3,606,441

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetanake komunale të buxhetuara dhe të shpenzuara.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 82% e buxhetit ishte shpenzuar nga kjo kategori.
- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 1,058,842€, Mallra dhe Shërbime për 369,373€, dhe Subvencione 55,315€ është si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i mëparshëm. Megjithatë, suficiti domethënës kundrejt buxhetit të rritur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është për shkak të vonesave në ekzekutimin e pagesave mbi mallrat dhe shërbimet. Pavarësisht kësaj, niveli i detyrimeve të papaguara vetëm për këtë kategori ishte 218,439€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	1,166,927	1,623,310	1,623,310	1,202,414	1,111,359

Të hyrat vetjake të mbledhura ishin 1,623,310€ duke përfshirë edhe gjobat e gjykatave dhe të trafikut. Krahasuar me vitin 2013, vërehet një rritje prej 420,896€ apo 35%. Variancat e shumave në mbledhjen e të hyrave në tri vitet e fundit kanë pasur një trend pozitiv.

Pjesa kryesore e të hyrave ishte realizuar nga tatimi në pronë (44%).

Çështja 6 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Pasqyra e shpenzimit të fondeve nxjerr në pah një nivel vazhdimisht të ultë të ekzekutimit të buxhetit nëpër vite, veçanërisht tek investimet kapitale (82%) dhe mallrat dhe shërbimet (69%).
- Rreziku** Ekzekutimi i dobët i buxhetit do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve financiare të komunës dhe në reduktimin e projekteve të planifikuara që të realizohen gjatë vitit.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurohet që një vlerësim real i arsyeve në lidhje me ngecjen e ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale, dhe mallra e shërbime është bërë, dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit për vitin 2015. Një monitorim sistematik i trendeve buxhetore do të rriste mundësitë për një performancë më efektive.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Komuna ka kontrole që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave. Megjithatë, ekziston një nevojë për përmirësim në disa procese për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së hyrave.

Çështja 7 - Tatimi në pronë - Prioritet i lartë

E gjetura Bazuar në të dhënat e ofruara nga menaxheri i tatimit në pronë, komuna për vitin 2014 kishte faturuar 16,178 obligues tatimor në vlerë 808,809€, ndërsa kishte arritur të inkasoj 721,747€. Ne kemi testuar 8 mostra me vlerë 55,548€, ku komuna kishte lidhur marrëveshje me obliguesit tatimor për t'i kryer obligimet me këste, dhe kemi vërejtur se këta obligues kishin paguar vetëm këstet e para, ndërsa këstet tjera nuk kishin paguar. Obligimet e mbetura për pagesë ishin 28,135€.

Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 e pronave të paluajtshme, si kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka arritur të azhurnoj sistemin me të dhëna, sepse ka pasur mungesa të zyrtarëve anketues në terren për verifikim të pronave.

Rreziku Tatimi në pronë është burimi kryesor i të hyrave të komunës, prandaj duhet të trajtohet me kujdes plani i inkasimit, sepse ka ndikim direkt edhe në realizimin e projekteve kapitale dhe financimeve tjera të parashikuara nga ky burim.

Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive., Veprime shtesë janë ndërmarr që të siguroj se tatimet mblidhen në nivelet e parashikuara. Duhet të bëhet verifikimi i pronave komunale siç parashihet me ligj.

Çështja 8 - Të hyrat nga pronat e dhëna me qira dhe taksat e biznesit- Prioritet i lartë

E gjetura Planifikimi i të hyrave nga qiraja ishte 35,000€, kurse realizimi 32,149€, apo 91%.

Komuna në bazë të evidencave në dispozicion, kishte lidhur 62 kontrata për qiradhënie të tokave dhe lokaleve afariste. Qiramarrësit kishin borxhe të grumbulluara dhe të papaguara prej 86,761€. Komuna kishte ndërprerë kontratat për 22 raste, mirëpo ende nuk janë ndërmarr hapa për mbledhjen e borxheve të mbetura nga qiramarrësit që kanë kontrata të vlefshme dhe atyre të ndërprera.

Planifikimi i të hyrave nga taksat e biznesit ishte 128,500€, kurse realizimi 30,126€, apo 23%. Borxhi i përgjithshëm për taksa biznesi është 578,359€. Veprimet e komunës për mbledhjen e borxheve të mbetura nga bizneset ishin të mangëta dhe jo mjaftë efektive.

Rreziku Komuna ka kontrolle të pa mjaftueshme mbi pronat e veta. Mungesa e veprimeve për inkasimin e qirave mujore dhe azhurnimin e kontratave për shfrytëzim të pronës komunale, rritë rrezikun që shfrytëzuesit e këtyre lokaleve dhe tokave të mos kryejnë obligimet financiare ndaj komunës dhe këto borxhe për prona dhe taksa në biznes të bëhen të pa mbledhshëm apo të shndërrohen në borxhe të këqija.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të siguroj një analizë të thellë të kontratave mbi pronat e komunës dhe aty ku e vlerëson të arsyeshme, të vazhdoj kohëzgjatjen e kontratave në pajtim me ligjet në fuqi. Të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike për shfrytëzuesit që nuk i shlyjnë obligimet financiare ndaj komunës. Po ashtu, të ndërmer masa mbi inaksimin e borxheve të taksave në biznes.

Çështja 9 - Të hyrat nën 10€- Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna e ka të funksionalizuar softuerin për pagesat deri në 10€, përveç në disa të zyre të gjendjes civile (ofiqari), që ende nuk ishte filluar me përdorimin e këtij sistemi, por pagesat bëhen në mënyrë manuale.

Rreziku Mungesa e funksionalizimit të softueri për të gjitha zyrat, rrit rrezikun që Komuna të mos posedoj informatat e duhura për të gjitha faturimet dhe inkasimet për të hyrat deri 10€.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë që deri në fund të vitit 2015 të funksionalizoj softuerin që për pagesat nën 10€ në të gjitha zyrat e gjendjes civile (ofiqaritë), i cili do të përfshinte detaje të përditësuara për paguesit.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Kontratat e nënshkruara përmes procedurave të prokurimit për vitin 2014 ishin në vlerë prej 2,296,254€. Këtu përfshihen kategoritë e Investimeve Kapitale dhe Mallra/Shërbimet.

Në Programin e Investimeve Publike (PIP), për vitin 2014 ishin të përfshira 26 projekte kapitale. Kemi vërejtur se emërtimi pagesa për vendime gjyqësore ishte regjistruar në PIP si projekt kapital. Po ashtu, kishte projekte kapitale që nuk ishin të përfshira në planin e prokurimit.

Komuna është e obliguar që për çdo tremujor t'i dorëzoj në kuvendit lokal dhe MF, një raport të detajuar për progresin e arritur të projekteve kapitale me vlerë mbi 10,000€. Këtë kërkesë ligjore komuna nuk ka arritur të përmbushë, edhe pse sistemi i PIP-it mundëson nxjerrjen e këtij lloj raporti që përfshin një listë të të gjitha projekteve që janë buxhetuar në vitin aktual.

Ne kemi analizuar nëse kontratat e nënshkruara për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe anasjelltas si dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara. Ne kemi vërejtur se 3 (tri) projekte të buxhetuara në vlerë 300,000€ nuk kanë mundur të realizohen, pasi që ishin ekzekutuar pagesa direkte nga thesari për obligimet e mëhershme duke pamundësuar realizimin e projekteve të buxhetuara.

Janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive.

Çështja 10 - Dobësitë sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura

Numri i madh i prokurimeve të realizuara përmes procedurave me vlerë minimale, është tregues i dobët i planifikimeve të prokurimit duke iu shmangur aplikimeve për procedura të hapura. Për blerje të njëjta dhe me operatorë të njëjtë, janë aplikuar procedura të prokurimit disa herë gjatë vitit. Kjo vërehet tek rregullimi i kanalizimeve në fshatra të ndryshme nga i njëjti Operator Ekonomik (OE) me vlera si; 453€, 2,258€ dhe 68,455 €. Kontratat për furnizime me OE të njëjtë me vlera si; 765€, 935€, 481€, 791€, 120€, 250€, 776€, 167€, 155€, 1,852€, 149€, 286€ dhe 140€. Kontratat për servisim veture me OE të njëjtë me vlera si; 950€ dhe 750€. Kontrata të ndryshme për furnizim me pajisje të IT dhe tonera me vlera si; 190€, 996€, 643€, 220€, 404€, 840€, 560€. Kontrata dyvjeçare për rehabilitim të kanalizimit nëpër fshatra me vlerë prej 82,559€ në muajin nëntor, ndërsa në muajin dhjetor me të njëjtin OE është lidhur një kontratë me vlerë prej 960€. Furnizim me gjenerator me vlera si; 935€ dhe 750€. Kjo tregon që nuk janë harmonizuar të gjitha nevojat e drejtorive komunale, duke ndikuar në shmangien e procedurave të hapura.

Rreziku Blerjet e shpeshta me vlera minimale dhe me OE të njëjtë, paraqet mundësinë e favorizimeve të OE të caktuar. Kjo mund të ndikojë që buxheti të shpenzohet në mënyrë joefikase, duke qenë se blerjet në këtë mënyrë mund të bëhen me çmime më të larta dhe kualitet më të dobët.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet t'i kushtoj rëndësi më të madhe planifikimit të prokurimeve dhe të siguroj se njësitë kërkuese do t'i analizojnë me kohë nevojat për blerje/furnizime dhe të njëjtat të jenë pjesë integruese e Planit vjetor të prokurimit. Praktikrat e prokurimit përmes procedurave të hapura, nxitin konkurrencën dhe mundësojnë nxjerrjen e çmimeve dhe cilësisë më të mirë nga tregu. Kësisoj, fondet do të shpenzohen në mënyrë më efektive, efikase dhe ekonomike.

Çështja 11 - Dobësitë josistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura Te kontrata "Furnizim me material shkollor" në vlerë 89,060€ operatori ekonomik para nënshkrimit të kontratës nuk e kishte sjell vërtetimin që nuk ka borxhe ndaj ATK-së si dhe sigurinë e ekzekutimit të kontratës;

Kontrata me kuotim çmimesh "Furnizim dhe montim i dyerve në shkolla fillore Vëllezërit Frashëri" me vlerë 4,976€, janë vërejtur këto mangësi: nuk kishte dëshmi se si janë njoftuar operatorët për ofertë, se sigurimi i ekzekutimit të kontratës i kërkuar për 1 vit ishte ofruar vetëm për dy muaj, mungonte plani për menaxhimin e kontratës, si dhe vendimi për caktimin e anëtarëve për hapje të ofertave;

Kontrata me kuotim çmimesh "Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta" me vlerë 2,750€, janë vërejtur këto mangësi; nuk kishte dëshmi se si janë njoftuar operatorët për ofertë, mungonte vendimi për caktimin e anëtarëve për hapje dhe vlerësim të ofertave si dhe vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës.

Rreziku Mos aplikimi i kritereve të kërkuara me dosjen e tenderit në vlerësimin e ofertave, mund të ndikoj në dhënien e kontratës OE të papërgjegjshëm, si dhe rrit rrezikun e mos realizimit të kontratës në mungesë të sigurisë së ekzekutimit.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të siguroj një rishikim të arsyeve se pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, të forcoj dhe të implementoj kontrole shtuara për të siguruar që një situatë e tillë nuk janë përsëritur.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Shpenzimet tjera janë shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Këto i përfshijnë komunalit, shpenzimet e udhëtimit dhe pagesat e bashkëfinancimit.

Çështja 12 - Marrëveshjet për bashkëfinancim dhe pagesat tjera - Prioritet i lartë

E gjetura Në përputhje me marrëveshjen ndërmjet International Relief Development (IRD), komunës dhe Kompania Rajonale e Ujërave KRU-së me 07.02.2014 nga kategoria investime kapitale kishte bërë pagesë 14,173€ në llogarinë e IRD-së, për projektin e ujësjellësit nëpër fshatra Kojškë dhe Rubovc, pa situacion për progresin e punës, raport të punës/mbikëqyrjes e as ndonjë raport për pranimin e punëve, Data e fillimit të punimeve sipas marrëveshjes ishte 01.04.2014.

Pagesa në vlerë 19,815€ bërë në llogarinë e International Organization for Migration (IOM) ishte paraqitur si transfer kapital për entitete publike. Ajo ishte bërë sipas një marrëveshje mes IOM-it dhe komunës, e datës 10.07.2014, e cila përcakton që komuna të financojë këtë shumë të mjeteve për rregullimin e shtratit të lumit Gadime.

Rreziku Pagesat e bëra në avans sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit, pa kërkesat për raporte transparente dhe në kohë mbi rezultatet dhe financat, rrit rrezikun që mjetet e shpenzuara nga komuna të mos arrin efektin e synuar.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë që marrëveshjet për projektet e bashkëfinancuara të rishqyrtohen. Paradhëniet duhet të bëhen pos nëse është bërë rishikim rigjoroz për rreziqet e tilla.. Përveç kësaj, marrëveshjet duhet t'i reflektojnë aranzhimet kontraktuale të cilat i ofrojnë një bazë të qartë për monitorim efektiv.

Çështja 13 - Pagesat direkte nga thesari për obligimet e papaguara - Prioritet i lartë

Rreziku Pagesa të ekzekutuara direkt nga thesari për vitin 2014 ishin 649,631€. Kjo është rezultat i vonesave të komunës në kryerjen e pagesave, dhe me kërkesë të operatorëve ekonomik, thesari u kishte bërë pagesa direkte operatorëve nga llogaria e komunës. Thesari kishte ekzekutuar pagesat në bazë të Nenit 39.2 të LMFPP, pas diskutimeve me komunën. Mos pagesa e obligimeve me kohë nga komuna ndaj operatorëve, mund ta shpie komunën në konteste gjyqësore, rezultati i të cilave mund të prish ekuilibrin buxhetor dhe të shpie në dështimin e projekteve të planifikuara.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar që për punët apo shërbimet e kryera, pagesat të bëhen në bazë të afateve të përcaktuara kohore dhe në pajtim me rregullat financiare.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 7,852,341€, ndërsa shpenzimet 7,801,404€ apo 99%.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet, dhe pagesat për anëtarët komunal. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Nga testimet e bëra kemi identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 14 - Ndërrimi i pozitave të personelit - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne kemi vërejtur se tre të punësuarve si nëpunës civil, Kryetari kishte bërë ndërrimin e pozitave të punës dhe kishte bërë transferimin e tyre në pozita tjera pune në kuadër të shërbimit civil të administratës komunale. Kjo ka ndodhur me shefin e sektorit për marrëdhënie me publikun dhe dy auditorë të brendshëm. Dy auditorëve të brendshëm, në fillim të vitit u ishte ulur koeficienti në pagë nga 15 në 7, e pastaj në gjysmën e dytë të vitit, ishin sistemuar në vende tjera të punës.

Transferimi i të punësuarve në pozita të tjera është i lejuar në kushtet e përcaktuara me dispozitat e Ligjit për shërbimin civil në Kosovë, mirëpo të gjitha ndërrimet duhet të bëhen sipas ligjit dhe në përputhje me strukturën organizative të personelit të administratës komunale.

Rreziku Ndërrimi i pozitave të punës në mospërputhje me strukturën organizative të administratës komunale mund të ndikoj në mos përmbushjen e detyrave të planifikuara të punës në njësi të caktuara organizative.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj që burimet njerëzore janë planifikuar në përputhje me nevojat për përmbushjen e detyrave dhe të bëjë sistemimin e të punësuarve sipas aktit për organizimin e brendshëm të administratës komunale.

Çështja 15 - Kontrollë të dobëta tek procesimi i pagesave- Prioritet i mesëm

E gjetura Në drejtorinë e arsimit dy mësime të cilat kishin shkuar në pushim të lehonisë nuk u i është bërë ndalesa prej 30%; njëres për një muaj dhe tjetres për dy muaj. Në mungesë të kontrolleve është bërë pagesa 100% e pagës.

Kemi testuar edhe pagesat e anëtarëve të kuvendit komunal dhe kemi vërejtur se dy anëtar të kuvendit komunal ishin paguar (njëri për tetë dhe tjetri për një muaj), edhe pse ata kishin dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit të komunës për këtë periudhë.

Rreziku Mungesa e kontrolleve të duhura në sistemin e pagave, mund të rrit rrezikun për pagesa të pa rregullta.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj që arsyet e gabimeve në pagesat e pagave janë rishikuar, si dhe të shtojë kontrollet tek menaxhimi i personelit në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera ndaj në mënyrë të pa drejtë, duhet të rishikohen dhe t'i kthehen buxhetit të komunës.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte 255,315€, ndërsa për vitin fiskal 2014 ishin shpenzuar 203,586€, apo 80%.

Komuna me datën 03/04/2014, kishte miratuar një rregullore të brendshme mbi ndarjen e subvencioneve.

Ne kemi identifikuar disa mangësi si në vijim:

Çështja 16 - Dhënia e subvencioneve jo në pajtim me rregulloren - Prioriteti i lartë

E gjetura Në 8 (tetë) raste, kryetari ka subvencionuar shuma prej 2,000€ mbi kufijtë e paraparë me rregullore. Sipas nenit 6 dhe 12 të rregullores për subvencione, kryetari duhet të merr pëlqim paraprak nga kuvendi i komunës për vlerat e përfituesve individual mbi 1,500€.

Rreziku Marrja e vendimeve mbi kufijtë e përcaktuar të rregullores për subvencionimin e personave juridik nga kryetari, nuk ishte në pajtim me kërkesat e rregullores.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj që subvencionimet të realizohen në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Rregullorës me Nr. 15-400-13203 të datës 03/04/2014, për ndarjen e subvencioneve.

Çështja 17 - Mungesa e raporteve-kthyesë nga përfituesit e subvencioneve- Prioritet i lartë

E gjetura Me datë 06.05.2014 kuvendi kishte marr vendim për ndarjen e mjeteve prej 5,500€ si subvencion për Sindikatën e Punëtorëve për mbulimin e obligimeve të krijuara nga sindikata për organizimin e ekskursionit dy ditor në Shqipëri. Me këtë vendim, përfituesi ishte obliguar që të raportoj në përputhje me specifikacionin e shpenzimeve të aprovuar. Nuk ishte ofruar dëshmi lidhur me destinimin e këtyre mjeteve sipas planit të aprovuar.

Raste të njëjta janë edhe: Subvencionimi i Klubit Futbollit "Ulpiana" në vlerë 2,000€, dhe Subvencionimi i fermerëve për minisera në vlerë 141€, KVRL - Lipjani në vlerë 2,000€, KF "Minatori" në vlerë 1,000€, "AKV-Lipjani" në vlerë 2,000€, "Eureka-film" në vlerë 2,000€, dhe subvencionimi për 6 (gjashtë) persona fizik për çështje sociale dhe shëndetësore.

Rreziku Mungesa e raporteve kthyesë për shpenzimin e mjeteve të përfituara, rrit rrezikun që mjetet e planifikuara për subvencione dhe transfere nuk kanë arritur objektivat e synuara.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të sigurojë që përfituesit e mjeteve nga subvencionet të raportojnë për mënyrën e shpenzimit të mjeteve, ashtu siç parashihet me rregullore dhe vendime të subvencionimit.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Menaxhimi i pasurive në Komunë ka treguar përmirësim të vazhdueshëm. Pasuritë kapitale mbi 1,000€ të regjistruara në vitin 2013 ishin 173,655,148€, ndërsa deri në fund të vitit 2014 vlera e pasurive të regjistruara ishte 176,283,313€. Komuna posedon regjistrat e kërkuar sipas rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, dhe kishte arrit të bëjë regjistrimin e investimeve në vijim.

Çështja 18 - Procesi i inventarizimit të pasurive - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte formuar komisionin për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive jo financiare, me datën 13/01/2015, mirëpo ky komision ende nuk kishin arrit ta përmbyllë procesin e inventarizimit dhe nuk kishte hartuar ndonjë raport përfundimtar.

Rreziku Në mungesë të raporteve të inventarizimit të fund vitit, menaxhmenti i komunës nuk mund të konfirmoj ekzistencën dhe funksionalitetin e pasurive në dispozicion. Kjo mund të rris rrezikun për ruajtjen, dobësitë menaxhuese me pasuritë, madje edhe për keqpërdorimin dhe humbjen e tyre.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i inventarizimit të përfundojë punën e tij dhe të hartoj raport përfundimtar për ekzistencën fizike dhe shkallën aktuale të funksionalitetit/përdorimit të pasurive, dhe rezultatet e inventarizimit t'i krahasoj me regjistrat kontabël dhe të bëjë korrigjimet e duhura.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna nuk kishte nxjerr dhe aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë dhe taksa për ushtrimin e veprimtarisë.

Çështja 19 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme -Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas të dhënave në listën e debitorëve ndaj komunës, llogaritë e arkëtueshme ishin në vlerë prej 3,663,794€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë (2,998,674€), ushtrimin e veprimtarisë në biznes (578,359€), dhe qiraja për lokale dhe toka (86,761€).
- Rreziku** Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në pamundësinë e komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve, dhe po ashtu, mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin e të hyrave të ngarkuara.
- Rekomandimi 17** Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Menaxhimi me borxhe në Komunë vazhdon të mbetet sfidë. Konkludimet tona të auditimit janë se trajtimi i borxheve dhe kontrollet ndaj tyre nuk funksionojnë mirë.

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2014 ishte 1,028,032€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015.

Shuma e mbetur e detyrimeve të papaguara është mjaft e lartë në krahasim me shumën totale të buxhetit të komunës dhe mund të ketë implikime serioze në arritjen e objektivave të vitit 2015, duke qenë se këto obligime duhet të paguhen nga buxheti i viti 2015.

Çështja 20 - Menaxhimi i dobët i borxheve - Prioritet i lartë

- E gjetura** Raporti i obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve për vitin 2014 ishte 1,028,032€. Detyrimet për paga dhe mëditje 263,781€, mallra, shërbime dhe komunalitë 230,576€, subvencione 3,300€ dhe investime kapitale 531,373€.
- Rreziku** Obligimet e mëdha të papaguara, rrisin rrezikun se planet e ardhshme të shpenzimeve nuk mund të arrihen për shkak të nevojës për të paguar borxhet e mbetura nga vitet e mëparshme.
- Rekomandimi 18** Për t'iu shmangur hapjes së kontesteve gjyqësore dhe ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari, Kryetari duhet të trajtoj me kujdes këtë situatë, dhe të merr masat e duhura që të planifikoj buxhetin e duhur për likuidimin e borxheve si dhe të parandaloj hyrjen në obligime të reja pa zotimin paraprak të fondeve.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Komuna e ka të themeluar NJAB, e cila deri në gusht 2014 i kishte 3 auditorë, ndërsa pas muajit gusht ka vetëm një auditor. Problemi në lidhje me Auditorin e Brendshëm është trajtuar te kapitulli 4.4.2. NJAB kishte hartuar planin strategjik dhe vjetor të auditimit. NJAB për vitin 2014 ka planifikuar dhjetë (10) auditime të rregullta. Për kundër reduktimit të stafit, NJAB kishte arritur ta përmbush planin duke i finalizuar 10 raporte të rregullta.

Auditori i brendshëm kishte planifikuar auditime me rrezik të lartë, si në fushën e të hyrave, prokurimit, shpenzimeve dhe menaxhimit të pasurive komunale.

Raportet e finalizuar janë:

- Auditimi i procedurave të prokurimit (Fushëveprimi; viti 2013);
- Auditimi i hyrave të tatimit pronë (Fushëveprimi; viti 2013);
- Auditimi i mallrave dhe shërbimeve në shëndetësi (Fushëveprimi; viti 2013 janar-shkurt 2014);
- Auditimi i menaxhimit të veturave zyrtare (Fushëveprimi; viti 2013/janar-prill 2014);
- Auditimi i zyrës së thesarit (Fushëveprimi; viti 2013/janar -prill 2014);
- Auditimi i hyrave në drejtorinë e shëndetësisë (Fushëveprimi; viti 2013);
- Auditimi i hyrave në drejtorinë e gjeodezisë, kadastër dhe pronë (Fushëveprimi; Maj 2013-korrik 2014);

- Auditimi i hyrave nga taksat për leje pune dhe taksat për dhënien e tokave dhe lokaleve komunale në shfrytëzim, (Fushëveprimi; Qershor 2013-Gusht 2014);
 - Auditimi i shpenzimeve në administratën komunale, (Fushëveprimi; Tetor 2013-Tetor 2014); dhe
 - Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive komunale, (Fushëveprimi; Nëntor 2013-Nëntor 2014).
-

Çështja 21 - Zbatimi i plotë dhe funksional i Sistemit të Auditimit të Brendshëm - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne kemi vërejtur se menaxhmenti nuk kishte trajtuar me kujdesin e duhur rekomandimet e dhënë nga NJAB, dhe si rezultat, vetëm një numër i rekomandimeve ishte zbatuar në drejtoritë e audituara. Gjithashtu, Komiteti i Auditimit nuk kishte adresuar çështjet e ngritura nga NJAB dhe nga auditimi i jashtëm, për faktin se ky komitet është themeluar me 05/09/2014 dhe kishte mbajtur vetëm dy takime. Po ashtu, komiteti i auditimit akoma nuk hartuar statutin që përcakton objektivat dhe fushëveprimin e tij.

Rreziku Mos përgatitja e një plani konkret nga menaxhmenti për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB, rritë rrezikun që dobësitë e identifikuara të mos korrigjohen, dhe rekomandimet e njëjta nga viti në vit, të përsëriten.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet të siguroj plan konkret ku do të përcaktoj se se do të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm. Çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm duhet të diskutohen dhe adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit. Komiteti i Auditimit të hartoj statutin ku specifikohet fushëveprimi dhe objektivat, dhe mbi këtë, bëj një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet e adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të analizoj arsyet për keq deklarimet lidhur me pagesat nga palët e treta dhe të siguroj se pagesat nga palët e treta të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PVF-të e vitit 2014.	x		
	Kryetari duhet të analizoj arsyet pse këto pasuri nuk janë regjistruar dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontroleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.		x	
	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që kërkesa nga plani i hartimit të PVF 2014 për rishikimin e draft llogarisë nga menaxhmenti zbatohet me fokus të veçantë në fushat ku pasqyrat kishin mangësi. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante për PVF-të.			x
3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se një plan i rishikuar, praktik njëkohësisht edhe sfidues, është hartuar për të adresuar rekomandimet e bëra nga AP duke caktuar stafin përgjegjës me një fokus fillestar në fushat më të rëndësishme. Zbatimi i këtij plani duhet të rishikohet nga kryetari në baza mujore.		x	
4.2 Qeverisja e mirë	Kryetari i Komunës duhet të merr masa të shpejta dhe të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar, përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato.		x	

4.3 Planifikimi dhe realizimi i hyrave	Kryetari duhet të siguroj se procesit të buxhetimit i paraprinë një analizë e plotë dhe vlerësim kritik për të gjitha kategoritë, me fokus të veçantë, projektet kapitale. Kryetari duhet të monitoroj performancën buxhetore në baza periodike dhe të adresoj pengesat që dalin në proces për realizimin e projekteve kapitale në mënyrë që të sigurohet se projektet po realizohen dhe objektivat po arrihen.		x	
4.4 Te hyrat	Kryetari i Komunës duhet të rishikoj sistemet ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur komuna për mbledhjen e të hyrave janë duke funksionuar në mënyrë efektive. Në të kundërtën, të ndërmarr veprime shtesë që të siguroj se tatimet mblidhen në nivelet e parashikuara.	x		
	Kryetari i Komunës duhet të rishqyrtoj në Asamblenë komunale çështjen e kontratave të skaduara, dhe aty ku e vlerëson të arsyeshme, të vazhdoj kohëzgjatjen e kontratave. Në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike për shfrytëzuesit që nuk posedojnë kontratat valide.		x	
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do merren masa të shpejta që ky problem të adresohet me prioritet. Rastet si të tilla duhet të trajtohen veç e veç, dhe të vlerësohet nëse këto objekte mund të legalizohen dhe cilat prej tyre duhet të rrënohen. Po ashtu, është e nevojshme që planet rregullative të diskutohen dhe miratohen, në mënyrë që investitorët, t’iu shmangen ndërtimeve pa leje. Duhet të ndërmerren masa administrative sipas nevojës.	x		
4.5 Shpenzimet	Kryetari i Komunës duhet të zbatoj një rishikim të brendshëm që të përcaktoj pse kërkesat specifike të prokurimit nuk janë adresuar në rastet e mësipërme, dhe të vendos kontrole shtesë që të gjitha dobësitë e identifikuara të adresohen në mënyrë efektive.	x		

	Kryetari i Komunës duhet të siguroj një monitorim më efektiv të proceseve të prokurimit përmes menaxherit të prokurimit, në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.		x	
	Kryetari i Komunës të analizoj arsyet pse vendimet e OSHP-së nuk janë zbatuar në këtë rast, të shtoj kontrollet tek procesi i vlerësimit të tenderëve në mënyrë që të ketë trajtim të barabartë të OE-ve gjatë vlerësimit të ofertave dhe rastet e tilla të mos përsëriten.		x	
4.5.3 Pagat dhe mëditjet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se kontratat për punë aprovohen vetëm nëse ka buxhet të mjaftueshëm dhe pozita të lira. Brenda një periudhe të specifikuar kohore, një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë dhe pagesat mbështeten në dokumentacionin e vlefshëm.	x		
4.5.4 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari i Komunës duhet që pa vonesë të miratoj një Rregullore që specifikon qartë kriteret dhe burimet e subvencioneve. Gjithashtu, duhet t'i rishqyrtoj rastet e përmendura dhe të përcaktoj pse kontrollet nuk janë aplikuar dhe të vendos kontrolle shtesë dhe të ndërmerr masa administrative në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.	x		
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj një planifikim më të mirë të shpenzimeve për subvencione, dhe zbatimin e buxhetit sipas ndarjeve fillestare, duhet të jetë objektiv i përhershëm i menaxhmentit.	x		
	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të respektohen kriteret e vendosura në konkurs dhe që komisioni për vlerësimin e aplikuesëve është i paanshëm, i drejtë dhe transparent në përzgjedhjen e përfituesve. Duhet të ndërmerren masa administrative sipas nevojës.	x		

4.6 Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që komisioni i formuar nga menaxhmenti të vlerësoj të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës. Gjithashtu, menaxhmenti duhet të monitoroj edhe rezultatet e vlerësimit.		x	
4.6.2 Trajtimi i borxheve	Kryetari i Komunës duhet të diskutojë me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë se si mund të mbulohen detyrimet.	x		
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë aprovimin e Planit të veprimit duke mbuluar afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe formoj komitetin e auditimit të brendshëm në mënyrë që t'i ndihmoj në adresimin e rekomandimeve të dhëna.		x	